



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0777
Data e Vendimit: 18.10.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik N.T.P. LULISHTJA BUÇAJ, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Parkut të Lodrave në Lagjen Ulpianë” me numër të prokurimit 616-23-6462-2-1-1, inicuar nga KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES nga cilësia e saj si autoriteti kontraktues (AK), Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 18/10/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e palejuar (parakohshme) ankesa e Operatorit Ekonomik (OE) N.T.P. “LULISHTJA BUÇAJ” me Nr. të Protokollit 2023/0777 e datës 10/10/2023, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Parkut të Lodrave në Lagjen Ulpianë”, me numër të prokurimit 616-23-6462-2-1-1, inicuar nga KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES nga cilësia e tij/saj si autoriteti kontraktues (AK).

I lejohet, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES-(AK) që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Parkut të Lodrave në Lagjen Ulpianë”, me numër të prokurimit 616-23-6462-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 10.10.2023, ka pranuar ankesën me Nr.Protokolli 777/23 nga OE N.T.P.” LULISHTJA BUÇAJ” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Parkut të Lodrave në Lagjen Ulpianë” me numër të prokurimit 616-23-6462-2-1-1, inicuar nga KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Me 22.06.2023, Kuvendi i Komunës se Prishtinës ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e lartcekur. Ndërsa me datën 20.09.2023 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK.

Me 04.10.2023, OE N.T.P. “LULISHTJA BUÇAJ” kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 12.10.2023, AK ka hedhur si të palejuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Parkut të Lodrave në Lagjen Ulpianë” me numër të prokurimit 616-23-6462-2-1-1, inicuar nga KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES-AK konstatohet se njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 22.06.2023 ndërsa me datë 20.09.2023 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK. Por që një operator ekonomik tjetër (Selman Networks) ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 25.09.2023 me ç’rast AK ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim dhe kishte kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim. Ende pa u publikuar vendimi nga ana e AK, OE ankues N.T.P. “LULISHTJA BUÇAJ” me datë 04.10.2023 kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së e cila me datën 12.10.2023 është hedhur si të palejuar nga AK, me arsyetimin se pas kthimit në rivlerësim aktiviteti i prokurimit nuk ka përfunduar respektivisht nuk është publikuar rezultati përfundimtar i këtij aktiviteti të prokurimit.

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së pas pranimit të vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, brenda afateve ligjore të parashtrorë kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 1 i LPP-së përcakton se: “Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliken me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.”Ndërsa neni 109 i LPP-së përcakton se: “Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e

interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji lidhur me nenit 59 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj si e till hedhet si e pa lejuar në kuptimin si e parakohshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES-AK, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit në fazën e rivlerësimit për aktivitetin “Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Parkut të Lodrave në Lagjen Ulpianë” megjithatë OSHP i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK ,duhet të veprojnë konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me 31 pika 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N.T.P. LULISHTJA BUÇAJ**
- Arkivës së OSHP-së: